



BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

**MBI SISTEMIMIN E LLAZAR DEVOLE SI RAST EMERGJENT REZIDENT PRANË
QENDRES PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUAR “LIRA”.**

Drejtoria e Shërbimit Social dhe Qendra “Lira”, bazuar në takimin e Ekipit Teknik Ndërsektorial me Nr.64 Prot, datë 20.11.2025, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë” VKM-në Nr.425, datë 27.06.2012 “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe private, të përkujdesit shoqëror për PAK” i ndryshuar, vendim nr. 518, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në vlerësimet e kryhera nga shërbimet shoqërore, VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2025 dhe PBA përfundimtare 2025-2027”.

JU RELATOI:

Të nderuar këshilltar !

Bazuar në takimin e Ekipit Teknik Ndërsektorial me Nr.64 Prot, datë 20.11.2025 për historikun dhe situatën në të cilën ndodhet z.Llazar Devole, janë diskutuar gjatë takimit historiku dhe problematika:

Z.Devole është lindur në Berat më 16.02.1957 dhe jton në lagjen “30 Vjetori” Berat, në banesën e tij dhe në pronësi. Në vitin 1986 z.Devole është diagnostikuar me crregullim skizofreni dhe që nga viti 2010 ndiqet nga QKSHM. Në fillim të viteve 1990 ai braktiset nga familjarët të cilët nuk jetontë më në Shqipëri dhe që nga ajo kohë ai jeton totalisht i vetëm.

Drejtoria e Shërbimit Social ka bërë përpjekje maksimale për ti ofruar shërbime po nga ana e z.Devole janë refuzuar duke parë edhe diagnozën e tij. Si pjesë e ofrimit të shërbimeve, Shërbimi Social është përpjekur vazhdimisht të kontaktojë me familjarët dhe vazhdomisht jemi përballur me indiferencë dhe neglizhencë prej tyre.



- Z.Devole paraqet sjellje të pakontrolluara në komunitet, haluçinacione si dhe mos kontroll të higjenës personale dhe të banesës së tij.
- Ka nevoja urgjente për vendosjen në një institucion rezidencial, ku mund të marr përkujdesjen e nevojshme për një jetesë të përshtatëshme pasi nuk mund të jetojë i pavarur.
- Ngritja e një plani ndërhyrje dhe vendosja e detyrave për institucionet përkatëse, me qëllim dhënien e ndihmës së nevojshme dhe stabilizimin e rastit.

Pas diskutimeve të ETN-së , u dakordësua si më poshtë dhe u lanë këto detyra:

- Specialistë të Qendrës Komunitare të Shëndetit Mendor, të shoqëruar nga efektivë të Policisë së Shtetit, do të kryejnë shoqërimin e z.Devole për realizimin e ekzaminimeve të domosdoshme pranë Spitalit Rajonal Berat.
- Akomodimi i z.Devole pranë qendrës rezidenciale “Lira”.
- Mjeku psikiatër dhe infermieri i Qendrës Komunitare të Shëndetit Mendor do të garantojnë administrimin e mjekimit të nevojshëm gjatë gjithë periudhës së qëndrimit të tij në qendër.
- Drejtoria e Shërbimit Social, Bashkia Berat do të përgatisë dokumentacionin e nevojshëm për garantimin e mbështetjes financiare dhe buxhetimin e Qendrës “Lira” për rastin e z.Devole, nëpërmjet paraqitjes së kërkesës në Këshillin Bashkiak Berat.

Është vlerësuar sistemimi në qendrën rezidenciale si rast emergjent duke vlerësuar situatën aktuale të z.Devole dhe nevojën për shërbime të shëndetit mendor.

Bazuar në legjislacionin në fuqi, dokumentacionin e administruar, vendimin e ETN-së, drejtoria e Shërbimit Social, Qendra “Lira” dhe koston shtesë financiare që duhet për z. Devole, miratojmë Llazar Devole të sistemohet si rast emergjent rezidente, pranë Qendrës “Lira”.

Bashkëngjitur relacionit gjeni dokumentacionin :

1. Minutat e takimit të Ekipit Teknik Ndërsektorial për z.Llazar Devole.
2. Kërkesa për sistemimin në shërbime të kujdesit shoqëror ose shërbime të shëndetit mendor.
3. Kërkesa për akomodim të tij nga NJVKSH Berat.
4. Vërtetim KMCAP,
5. Çertifikata të ndryshme.
6. Formular tip 2.
7. Karta ID.

Adresa:Blvd. “Republika 2”, Berat 5001.Shqipëri,Tel /00355(0) 2 32 34 935, Ëëbsite: [ëëë.bashkiaberat.gov.al](http://eëë.bashkiaberat.gov.al), Email : bashkiaberat@yahoo.com



8. Informacion nga ASHK.
9. Analizat laboratorike.

DREJTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

Piro Xheblati



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

RELACION

MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR TË BUXHETIT TË SHTETIT TË MBROJTJES CIVILE

Të nderuar këshilltarë !

Në mbështetje të ligjit nr 45/2019 “ Për mbrojtjen civile” dhe të VKM nr 414 datë 08.07.2021 “ Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” pika 3.1 gërma b, pika 5 , shkresës së Ministrisë së Mbrojtjes nr. 2126/1 prot datë 19.02.2025” Mbi akordimin e fondeve të kushtëzuara për vitin 2025” ku Bashkisë Berat i është akorduar fondi në shumën 11,521,812.34 lekë.

Këshilli Bashkiak me Vendimin nr. 49, datë 26.06.2025, “Mbi Përdorimin e Fondit të Kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit të Mbrojtjes Civile”, nga Kodi Produktit 91707AG me vlerë 9,500,000 lekë, ka miratuar për përdorim një shumë prej 9,296,824.10 lekë për realizimin e masave në fushën e mbrojtjes civile”

Nga procesi i prokurimit, i zhvilluar për këtë qëllim është realizuar kontraktimi dhe ekzekutimi i fondeve në vlerën **6,977,011.12 lekë**, duke sjellë një kursim buxhetor prej **2,522,988.88 lekë** nga totali i fondit të akorduar për këtë qëllim.

Gjithashtu nga ky fond i kursyer me Vendimin nr. 75, datë 20.10.2025, “Mbi Përdorimin e Fondit të Kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit të Mbrojtjes Civile”, nga Kodi Produktit 91707AG me vlerë 9,500,000 lekë, ka miratuar për përdorim një shumë prej **2,354,267.60** lekë për realizimin e masave në fushën e mbrojtjes civile” Nga procesi i prokurimit i zhvilluar për këtë qëllim është realizuar kontraktimi dhe ekzekutimi i fondeve në vlerën **1,694,040 lekë**, duke sjellë një kursim buxhetor prej **828,948.88 lekë** nga totali i fondit të akorduar për këtë qëllim.

Bashkia Berat bazuar në:

-Verifikimet në terren të kryera nga strukturat teknike të bashkisë,

-Kërkesat e përsëritura të komunitetit për ndërhyrje në zona me rrezikshmëri të lartë,

Propozohet që fondi i kursyer të përdoret për:

1. Ndërhyrje në zonën me risk të lartë, për forcimin e strukturave mbrojtëse dhe stabilizimin e terreneve që paraqesin rrezik për jetën e qytetarëve;

Ky përdorim është në përputhje të plotë me qëllimin dhe objektivat e fondit të Mbrojtjes Civile, si dhe me prioritetet e Bashkisë Berat për garantimin e sigurisë së komunitetit. Për sa më sipër, paraqitet për miratim nga Këshilli Bashkiak nga shuma e kursyer prej **826,255.7** lekë për qëllimin e përmendur më lart për:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

- Në Lagjen “28 Nëntori”, rruga Uzguriliu, Rajoni Nr.2 kemi mungesë të murit mbajtës në këtë segment duke rrezikuar stabilitetin dhe integritetin strukturor të trupit të rrugës, vlera: 826,255.7 lekë me tvsh, l=25 ml.

Bashkëngjitur do të gjeni dokumentacionin teknik.

Ju faleminderit,

KRYETARI I BASHKISË

Ervin CECA

Drejtoria e Planifikimit Urban, Erida Nasufi-Drejtore

Drejtoria e MCPTSH, Sokol Toska-Drejtore

Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Rovenia Shehu-Drejtore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

RELACION

“MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË BERAT, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO-LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJEN E Z.LEONARD ZEKA BANESA E TË CILIT ËSHTË DËMTUAR NGA SHIRAT, NGA BUXHETI I BASHKISË DHE BUXHETI I VITIT 2025 NË MINISTRINË E MBROJTJES, PROGRAMI “EMERGJENCAT CIVILE”

Të nderuar Këshilltarë,

Në datën 28.09.2025 nga shirat e rëna u dëmtua duke u përmytur nga mosfunksionimi i kanalit të ujërave të larta banesa e z.Leonard Zeka ndodhur në Fshatin Orizaj, Njësia Administrative Otlak, Bashkia Berat.

Pas arkivimit të kërkesës së z.Leonard Zeka, me nr.1477 prot, datë 29.09.2025 komisioni i ngritur me Urdhërin nr.692 datë 03.10.2025 të Kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e komisionit për konstatimin e dëmeve të shkaktuara nga shirat në datën 28.09.2025 në banesën e shtetasit Leonard Zeka ndodhur në Fshatin Orizaj Njësia Administrative Otlak, Bashkia Berat” shkoi në vendngjarje dhe në bazë të konstatimit fizik, hartoi proces -verbalin e dëmeve të shkaktuara, mbështetur në VKM nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret për procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”

Proces verbali i konstatimit u përcoll në Këshillin e Qarkut me shkresën nr.6137 Prot, datë 27.10.2025, për vlerësimin e dëmeve sipas ligjit.

Komisioni i Ekspertëve të Këshillit të Qarkut ka përfunduar vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në banesën e z.Leonard Zeka dhe është përcjellë në Bashkinë Berat me shkresën nr. 6137/1 Prot. datë 12.11.2025.

Në mbështetje të preventivit të hartuar nga grupi i ekspertëve dërguar në Bashkinë Berat rezultojnë dëmet:

1. Në banesën e z.Leonard Zeka në vlerën	311,830 lekë.
- Punime ndërtimore	54,330 lekë.
- Orendi dhe pajisje	257,500 lekë.

Bazuar në dokumentacionin që disponojmë dhe mbështetur në VKM nr.329 datë 16.05.2012, shkronja “ç”, të pikës 1, të Kreut III, i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratoj vlerën e ndihmës së menjëherëshme financiare për:

Familjen e z.Leonard Zeka në vlerën 155,915 lekë.

Ndihma financiare do të përballohet nga fondet e akorduara nga buxheti i shtetit për mbrojtjen civile me shkresën e Ministrisë së Mbrojtjes nr. 2126/1 prot datë 19.02.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

“Mbi akordimin e fondeve të kushtëzuara për vitin 2025” për Bashkinë Berat për sigurimin e jetës dhe kushteve të përkohëshme të jetesës, si dhe për shpenzime të tjera për përballimin situatës emergjente.

DREJTOR I MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

Sokol Toska



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE , PRONAVE, TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

RELACION

**MBI MIRATIMIN E LISTËS NR.9 TË FAMILJEVE TË PASTREHA QË DO TË
TRAJTOHEN ME KREDI ME INTERES 3%**

Të nderuar Këshilltare !

Bashkia Berat në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit vazhdon zbatimin e projektit “Banesë me kosto të ulët, subvencionim të interesave të kredise”.

Ministria ka bërë përzgjedhjen e bankave që do të menaxhojnë këtë projekt nëpërmjet subvencionimit të interesave të kredisë nga buxheti i shtetit dhe konkretisht: Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare dhe Banka Intesa Sanpaolo.

Programi i subvencionimit të interesave të kredisë trajton familje /individë që kanë aplikuar në portalin e –albania “Kërkesë për t’u trajtuar me programin e strehimit social banesë me kosto të ulët, Subvencionim i interesave të kredise së zbutur”.

Përparësi në përzgjedhje për t’u trajtuar me këtë projekt kanë familjet që plotësojnë kriteret e përcaktuar në ligjin 22/2018 “Për strehimin social” i ndryshuar të cilat janë:

Kushtet e strehimit ku përparësi kanë familjet që:

- nuk disponojnë banesë në pronësi;
- banojnë në banesa që paraqesin rrezik shembjeje;
- banojnë në banesa të mbipopulluara;

Kushtet familjare ku përparësi kanë familjet që:

- familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë;
- të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit;
- familjet me më shumë se katër fëmijë ;
- çiftet e reja .

Kushtet sociale ku përparësi kanë familjet që:

- personat me aftësi të kufizuar ;
- vajzat nëna ;
- anëtar të komunitetit rom e egjiptian;
- individë me status të jetimit etj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kushtet ekonomike janë në përputhje me madhësinë e përbërjes familjare të përcaktuara nga INSTAT.

Bashkia Berat për ta bërë procesin sa më transparentë në mënyrë që të mos penalizohet asnjë familje e interesuar dhe që plotëson kushtet e nivelit të të ardhurave mujore në fillim të procesit ka bërë njoftim në faqen zyrtare të bashkisë ëëë.bashkiaberat.gov.al më datë 30.09.2025 "*Mbi fillimin e projektit të subvencionimit të interesave të kredise*", ku janë publikuar dokumentacioni përkatës dhe kriteret që duhet të plotësojë çdo person i interesuar i cili ka aplikuar si i pastrehë në portalin e-albania.

Komisioni i Strehimit i mbledhur më datë 25.11.2025, ka miratuar subvencionimin e kredise për 8(tetë) familje të pastreha që do të trajtohen me kredi me interes 3%, të cilat plotësojnë kriteret ligjore dhe dokumentacionin përkatës, sipas tabelës bashkelidhur.

Ndërsa 10 familje u s'kualifikuan për mungesë dokumentacioni dhe për mos plotësim të kriterëve kualifikuese.

DREJTOR I MROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

Sokol Toska



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

RELACION

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 108 DATË 18.12.2024 " PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË BERAT PËR VITIN 2025 DHE PBA 2025-2027 ", i ndryshuar, (shtesë e buxhetit 2025 me fondin për parafinancimin e projektit me financim të huaj "HEVON" dhe detajimi i saj)

Të nderuar këshilltarë!

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 40, pika 1, neni 41, pika c, 54, gërma "dh", neni 64 gërma "c", ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 6, gërma "d", neni 28, pika 5, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin plotësues nr. 2 datë 24.01.2025 të Ministrit të Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025"; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 108 datë 18.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2025 dhe PBA 2025-2027";

paraqesim propozimin e mëposhtëm për një shtesë në buxhetin e vitit 2025 të Bashkisë Berat:

Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 15419/1 prot datë 05.11.2025 " Transferim fondi për shpenzime kapitale", Bashkisë Berat i është akorduar fondi prej 2,138,258 Lekë për shpenzime kapitale për produktin " Fond MFE për parafinancimin projekti me financim të huaj "HEVON / No.SA030412", si mbështetje me fondin për parafinancim në kuadër të projekteve të huaja nga Ministria e Financave

Projekti HEVON parashikon një sërë aktivitete, nga të cilat me të ardhurat si fond i parafinancimit do të realizohet: Ekspertizë e jashtme për menaxhimin e projektit "HEVON"

Duke qenë se projekti sjell përfitime konkrete në zhvillimin ekonomik vendor, rritjen e cilësisë së produkteve lokale dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal, kërkohet miratimi i shtesës në buxhet në shumën 2,138,258 lekë për përfshirjen e tij në buxhetin e Bashkisë Berat si mbështetje financiare për parafinancim për zbatimin e suksesshëm të projektit HEVON.

shtesa

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Shuma lek
2102001		Bashkia Berat (Aparati)				2,138,258
2102001		AD102	Bujqësia, Administrimi i Pyjeve, Ujërrave, Shërbimi Veterinar & Siguria Ushqimore			2,138,258
2102001	01	AD102	90005AB	602	Shpenzime për menaxhimin e projektit "HEVON" (Fond MFE për parafinancimin projekti me financim të huaj "HEVON / No.SA030412")	2,138,258
Total						2,138,258



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin ,

KRYETAR

Ervin CEÇA

Drejtorja e Integritimit EU dhe Projekteve

Marius Çiftiku

Drejtorja e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave

Doriana Shtetari

Drejtorja Juridike

Petro Sinjari



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE PROJEKTEVE

Berat, më: ____ . 2025

RELACION

MBI

NDRYSHIMIN E VENDIMIT NR.16, DATË 05.03.2025
“RIKONSTRUKSIONI I QENDRËS RINORE LAPARDHA”

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkia Berat është përfituese e projektit “Rikonstruksioni i Qendrës Rinore Lapardha”

Në kuadër të politikave të Bashkisë Berat për zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve rurale dhe fuqizimin e infrastrukturës kulturore e rinore, është përgatitur projekti “Ri-konstruksioni i ish-‘Pallatit të Kulturës’ në Lapardha” i cili është aktualisht duke u zbatuar me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare për Rininë dhe me një pjesë të fondit të Bashkisë Berat.

Qëllimi kryesor i projektit është rikonstruksioni total i objektit, përfshirë ndërhyrjet strukturore, restaurimin e fasadës, rifreskimin e ambienteve të brendshme, instalimet elektrike, ndriçimin, sistemet e ventilimit etj që do t’i japin godinës funksione të reja komunitare dhe rinore.

Në kuadër të zbatimit të projektit janë parashikuar gjithashtu aktivitete për rritjen e vizibilitetit, përmes komunikimit publik, materialeve promovuese dhe publikimeve në rrjete sociale, si dhe një ceremoni përmbylëse me pjesëmarrjen e përfaqësuesve institucionalë dhe të komunitetit lokal, që do të shërbejë për prezantimin e rezultateve dhe promovimin e qëndrueshmërisë së investimit.

Zbatimi i këtij projekti do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në ringjalljen e jetës kulturore të zones, forcimin e identitetit komunitar dhe rritjen e mundësive për pjesëmarrje rinore.

Këshilli Bashkiak me vendimin Nr.16, datë 05.03.2025 ka miratuar këtë projekt, përfshirë edhe kushtet e financimit dhe bashkëfinancimit. Me anë të këtij vendimi nevojitet që të rialokohet një pjesë e fondit të parashikuar për investime. Specifikisht nevojitet që nga fondi me vlerë 15,335,758 lekë të alokohet për shpenzime operacionale vlera 155,000 lekë e parashikuar për materiale promocionale, si dhe fondi me vlerë 100,000 lekë parashikuar për organizmin e një ceremonie përmbylëse.

Faleminderit,

KRYETARI I BASHKISË
ERVIN CECA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKT – VENDIM

MBI

**NDRYSHIMIN E VENDIMIT NR.16, DATË 05.03.2025
“RIKONSTRUKSIONI I QENDRËS RINORE LAPARDHA”**

Nr. _____, Datë2025

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës2025, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore, Ligjit Nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligjin nr.162, datë 23.10.2020 “Për Prokurimin Publik,” i ndryshuar, Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.108, datë18.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Beratë vitit 2025 dhe PBA 2025-2027”, Udhëzimit të Ministrit të Financës nr.9, datë20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin plotësues nr.2, datë 24.01.2025 të Minstrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, si dhe me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI:

1. Të ndryshohet pika 2 e vendimit të këshillit Bashkiak Nr. 16 Datë 05.03.2025. Pas fjalisë së parë të pikës 2 të vendimit të shtohet fjalia si më poshtë:

Shuma e bashkëfinancimit prej 15,335,758 të përdoret në vlerën në vlerën prej 15,080,758 për investime dhe në vlerën 255,000 për shpenzimet operacionale. Shpenzimet operacionale do të konsistojnë konkretisht në 155,000 lekë parashikuar për materiale promocionale, si dhe 100,000 lekë parashikuar për organizmin e një ceremonie përmbyllëse.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave si dhe Drejtoria e Integritimit Evropian dhe Projekteve

Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut.

**KRYETAR
EVISA ÇELA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

RELACION

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 108 DATË 18.12.2024 " PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË BERAT PËR VITIN 2025 DHE PBA 2025-2027 ", i ndryshuar, (shtesë e buxhetit 2025 me transfertën e pakushtëzuar sektoriale për shpërblimin e punonjësve të angazhuar në shuarjen e zjarreve dhe detajimi i saj)

Të nderuar këshilltarë!

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 40, pika 1, neni 41, pika c, 54, gërma "dh", neni 64 gërma "c", ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 6, gërma "d", neni 28, pika 5, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin plotësues nr. 2 datë 24.01.2025 të Ministrit të Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025"; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 108 datë 18.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2025 dhe PBA 2025-2027"; paraqesim propozimin e mëposhtëm për një shtesë në buxhetin e vitit 2025 të Bashkisë Berat:

Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 14505/11 prot datë 24.10.2025 " Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 10, datë 08.10.2025 ", Bashkisë Berat i është akorduar fondi prej 3,534,000 Lekë . Ky fond është akorduar për të ndihmuar bashkitë për shpërblimin e punonjësve të angazhuar në shuarjen e zjarreve, në masën deri në një pagë.

Kriteret e shpërndarjes së shpërblimit janë përcaktuar në pikën 3 të VKM-së nr. 483 datë 02.09.2025 "Për dhënie shpërblimi të personelit të angazhuar në operacionet për shuarjen e zjarreve gjatë vitit 2025". Nga kalkulimet e kryera, fondi total i nevojshëm për shpërblimin e punonjësve rezulton 8,277,903 lekë. Bashkia i është drejtuar Ministrisë së Financave për financimin e plotë të shpërblimit të punonjësve, pasi fondi ishte i paparashikuar dhe domethënës. Nga Ministria përkatëse janë akorduar 3,534,000 lekë, duke krijuar kështu një mangësi prej 4,743,903 lekësh për përmbushjen e detyrimeve sipas VKM.

Transferta e pakushtëzuar sektoriale për funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, të detajohet si më poshtë :



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Shuma lek
2102001					Bashkia Berat (Aparati)	3,534,000
2102001		AE102			Siguria dhe Mbrojtja e Territorit	3,534,000
2102001	01	AE102	V328AAB	600	Shpërblim i punonjësve të angazhuar në shuarjen e zjarreve	3,534,000
Total						3,534,000

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin ,

KRYETAR

Ervin CECA

Drejtorja e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave

Drejtorja Juridike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

RELACION

PËR
PËRDORIMIN E FONDIT REZERVË PËR SHPËRBLIMIN E PUNONJËSVE TË ANGAZHUAR NË
SHUARJEN E ZJARREVE GJATË VITIT 2025

Të nderuar këshilltarë!

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 483, datë 02.09.2025, "Për dhënie shpërblimi të personelit të angazhuar në operacionet për shuarjen e zjarreve gjatë vitit 2025", Bashkia Berat ka kryer vlerësimin financiar të nevojshëm për ekzekutimin e këtij detyrimi ligjor.

Sipas VKM-së së sipërpërmendur, punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin në bashki, përfitojnë shpërblim në masën tre paga mujore, si vlerësim për angazhimin, gatishmërinë, si dhe përkushtimin e treguar në menaxhimin dhe shuarjen e zjarreve gjatë sezonit veror, me kohëzgjatje 16 (gjashtëmbëdhjetë) ditë e më shumë .

Punonjësit e MZSH Berat kanë marrë pjesë në operacione të vazhdueshme jo vetëm në territorin e Bashkisë Berat, por edhe në bashki fqinje, sipas kërkesave për mbështetje ndërinstytucionale, duke garantuar reagim të shpejtë dhe profesional në situata emergjente.

Nga kalkulimet e kryera, fondi total i nevojshëm për shpërblimin e punonjësve rezulton 8,277,903 lekë. Bashkia i është drejtuar Ministrisë së Financave për financimin e plotë të shpërblimit të punonjësve, pasi fondi është i paparashikuar dhe domethënës. Nga Ministria e Financave, me shkresën nr. 14505/11 prot datë 24.10.2025 " Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 10, datë 08.10.2025 ", është akorduar fondi prej 3,534,000 Lekë për të ndihmuar bashkinë për shpërblimin e punonjësve të angazhuar në shuarjen e zjarreve, në masën deri në një pagë. Në këto kushte krijohet një mangësi prej 4,743,903 lekësh për përmbushjen e detyrimeve sipas VKM.

Për të garantuar zbatimin e plotë të vendimit të Këshillit të Ministrave dhe për të vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të merituar punonjësit e strukturës zjarrfikëse, Bashkia Berat propozon që pjesa e mungesës financiare, në shumën prej 4,743,903 lekë, të mbulohet nga fondi rezervë i buxhetit të Bashkisë. Fondi rezervë& kontigjencës është planifikuar 12 milion lekë dhe nuk është përdorur deri tani.

Ky angazhim buxhetor vlerëson kontributin e jashtëzakonshëm të punonjësve të MZSH-së, të cilët gjatë kësaj periudhe kanë treguar profesionalizëm, sakrificë dhe gatishmëri të vazhdueshme për mbrojtjen e jetës, pasurisë dhe mjedisit, duke ndërhyrë në situata të rrezikshme dhe shpesh përtej territorit administrativ të Bashkisë Berat.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Për sa më sipër, kërkohet miratimi i Këshillit Bashkiak për përdorimin e fondit rezerve në shumën 4,743,903 lekës , si lartpërmendur.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin ,

KRYETAR

Ervin CECA

Drejtorja e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave

Donat SHEN

Drejtorja Juridike

Petro Sinjan

Drejtor i MZSH-së

Komisar Artan Mehta